



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 03-03/DPK
Br. Prot. 01-2055/16
Prot No.
Data 15.06.2016
Datum
02
Date
PRISHTINE

DATË/A:	14/06/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03/1957/16
PËR/ZA/TO:	z. Haxhi BEJTA Menaxher i Prokurimit - Komuna Skenderaj
CC:	z. Fadil NURA Nënkryetar – Komuna Skenderaj
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Furnizimi me dru për ngrohje për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Skenderajt”

I nderuar z. BEJTA,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nën par. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nën par. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nën par. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Furnizimi me dru për ngrohje për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Skenderajt” me numër prokurimi: 643/16/012/121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull: “Furnizimi me dru për ngrohje për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Skenderajt” me numër prokurimi: 643/16/012/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Komuna Skenderaj keni iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: "Furnizimi me dru për ngrohje për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Skenderajt" me numër prokurimi: 643/16/012/121, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 01/06/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të hapur për furnizim.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsion ka hasur në kritere që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 keni kërkuar: *Kontrata ose referenca për shërbime në lëmin e furnizimeve me dru për ngrohje (të ngjashme) në tri vitet e fundit 240,000.00€*. Ndërsa vlera e parashikuar e kontratës është 120,000.00 €. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrajnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. Në rastin e juaj keni kaluar mbi 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës. Po ashtu në të njëjtën rubrikë përshkruese të dosjes së tenderit, pika 9.1, kërkesa numër dy, keni kërkuar: *Mekanizimi të ketë minimum tre kamion në pronësi me peshë mbi 10 tonë për shpërndarje të druve*. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve, por jo që për të njëjtat pajisje operatori ekonomik të jetë pronar. Operatorit ekonomik duhet ti mundësohet që në rast të mos pasjes së mjeteve teknike për realizimin e kontratës, ti marrë në shfrytëzim nga persona të tretë, ku duhet autoritetit kontraktues ti dëshmoj marrëveshjen për shfrytëzim të mjeteve përkatëse. Referuar në legjislacionin aktual për prokurim publik, përcaktimi kritereve të tilla mund të favorizon furnizuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminon të tjerët.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi; Nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare si dhe neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !